

NJOFTIM

Sot, më datë **09.03.2023**, ora **16:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Edlira Petri (relatore);**
- 2. Marsela Dervishi (anëtare);**
- 3. Blerona Hasa (anëtare);**
- 4. Manjola Xhaxho (anëtare);**
- 5. Esmeralda Xhili (anëtare).**

në seancë gjyqësore të zhvilluar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, pasi shqyrtoi çështjen që i përket:

Paditës: Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioni i Ankesave dhe Sanksioneve.

Objekt: Ndryshimin e Vendimit të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve nr. 07, datë 25.01.2023, për shqyrtimin e kërkesës nr. 04, datë 14.12.2022, të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke vendosur rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për subjektin politik Lëvizja për Zhvillim Kombëtar.

Baza Ligjore: Kodi Zgjedhor i R.Sh, i ndryshuar, Kodi i Procedurave Administrative, i ndryshuar, nenet 23, 23/4, pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

me vendimin Nr. 3, datë 09.03.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e padisë.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

Tiranë, 09.03.2023.

Tiranë, më 09.03.2023.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë